



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Financave – Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance

PASQYRA E ZHVILLIMEVE EKONOMIKE

Tremujori i Katërt – 2016

Pasqyra publikohet çdo tremujor në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe përdorimi i të dhënave nga ky publikim lejohet vetëm me citimin e burimit. Për çdo dallim mes versioneve, mbizotëron ai në gjuhën shqipe.

*Departamenti për Politika Makroekonomike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar
Mars 2017*


Inflacioni

Inflacioni gjatë tre muajve të fundit të vitit 2016 ishte 0.9% në tetor, 0.9% në nëntor dhe 1.3% në dhjetor. Duke u bazuar në këto shifra mujore, mund të konkludohet se norma mesatare e inflacionit gjatë tremujorit të katërt të vitit 2016 ishte 1.0%. Kjo nënkupton se tremujori i fundit i 2016 pati ngritjen më të lartë të çmimeve të konsumit brenda dy viteve të fundit. Në Grafikun 1.1 vërehet se nga muaji gusht fillon një ngritje e dukshme e çmimeve krahasuar me një nivel neutral që mbajtën gjatë pjesës më të madhe të vitit. Fundi i vitit ka një rritje të dukshme, duke arritur një mesatare prej 1% brenda vetëm 3 muajsh, kryesisht si pasojë e ndryshimeve në çmimin e naftës.

Çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike kanë filluar të rikuperohen gjatë TM4 2016. Gjatë periudhës tetor – dhjetor 2016 kjo kategori u rrit mesatarisht për 0.17%. Gjithnjë sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), gjatë TM4 2016 ngritje pati edhe te kategoria për strehim, ujë, rrymë, gaz dhe lëndë të tjera djegëse, me 13.9% gjatë muajit tetor, 0.2% në nëntor dhe 0% gjatë dhjetorit. Gjithashtu gjatë tremujorit të fundit të 2016 indeksi i nëngrupit për duhan dhe pije alkoolike u ngrit mesatarisht për 0.77%. Një nga faktorët që mund të ketë ndikuar në një nivel të tillë relativisht të ulët të çmimeve mund të jetë edhe pakoja fiskale që hyri në fuqi shtatorin e 2015.


Derisa 2015 u përmyll me deflacion prej 0.5%, gjatë vitit 2016, Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) në Kosovë shënoi rritje prej 0.3%. Trendi vjetor i paraqitur grafikisht në Figurën 1.1 gjithashtu tregon për një rritje relativisht të lehtë të inflacionit gjatë këtij viti. Ngritja e lehtë e çmimeve në Kosovë pritet të vazhdojë edhe në të ardhmen e afërt. Duke u bazuar në Kornizën Makro-Fiskale 2017 – 2019, pritet që gjatë tri viteve të ardhshme inflacioni vjetor të jetë mesatarisht 0.7%. Kjo kryesisht pritet të ndodh si rezultat i rimëkëmbjes së çmimeve ndërkombëtare të inputeve si derivatet dhe metalet.

Figura 1.2 Inflacioni në baza tremujore, 2015-2016



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës
Shënim: Mesatarja e vitit 2015 shërben si periudha bazë

Figura 1.1 Inflacioni mujor në Kosovë, dhjetor 2015 – dhjetor 2016




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Tregtia e Jashtme

Gjatë tremujorit të fundit të 2016, Kosova eksportoi mallra në vlerë prej 83.7 milionë euro, ndërsa importi arriti në 747.7 milionë euro. Krahasuar me TM4 2015, kjo i bie që eksporti gjatë pjesës së fundit të 2016 ishte për 12.5% më i lartë se ai në fund të 2015. Ndërsa vlera e mallrave të importuar është për 4.8% më e lartë në TM4 2016 se në TM4 2015. Deficiti tregtar gjatë tremujorit të katërt të vitit 2016 ishte 3.9% më i lartë se periudha e njëjtë e vitit 2015, si dhe për 1% më i ulët se tremujori i tretë i vitit 2016.

Në bazë të të dhënave vjetore, gjatë vitit 2016 importi i mallrave shënoi rritje për 5.9% në krahasim me vitin 2015, përderisa eksporti i mallrave shënoi rënie prej 4.8%. Vlera e importit të mallrave gjatë vitit 2016 arriti në 2 miliardë e 790 milionë euro, ndërsa vlera e eksportit të mallrave ishte rreth 310 milionë euro.

Figura 2.1 Bilanci Tregtar



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Tabela 2.1 Importet/Eksportet sipas vendeve, 2015 - 2016

	Exporti				Importi				
	2015	2016	% në total 2015	% në total 2016	2015	2016	% në total 2015	% në total 2016	
Shqipëria	40,253,724	42,053,582	12.37%	13.58%	Serbia	382,129,412	387,783,011	14.50%	13.90%
Serbia	32,261,855	41,330,530	9.92%	13.35%	Gjermania	290,947,748	342,960,182	11.04%	12.29%
Kazakistan	8,262,407	39,077,338	2.54%	12.62%	Turqia	252,285,230	288,502,660	9.58%	10.34%
Maqedonia	33,355,447	38,573,379	10.25%	12.46%	Kina	232,925,003	258,485,482	8.84%	9.27%
Zvicra	11,721,341	16,761,839	3.60%	5.41%	Italia	226,475,955	202,730,253	8.60%	7.27%
Gjermania	11,692,823	13,841,718	3.59%	4.47%	Maqedonia	143,845,932	156,714,977	5.46%	5.62%
Holanda	8,420,197	11,881,108	2.59%	3.84%	Greqia	110,259,606	118,517,073	4.18%	4.25%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Tabela 2.2 Importet/Eksportet sipas Sektorëve

	Eksporti		Importi		
	2015	2016	2015	2016	
Produkte bimore	15.54	16.82	Ushq.pije dhe duhan	352.68	373.05
Ushq.pije dhe duhan	25.44	27.65	Makineri,pajisje mek.&elek.	310.40	357.89
Produkte minerale	41.61	63.88	Produkte minerale	404.15	327.52
Plastikë dhe gomë	23.47	28.87	Metale bazë	260.55	275.43
Metale bazë	157.73	111.18	Produkte të ind. kimike	213.84	221.53
Tjera	61.50	61.28	Tjera	1,093.07	1,234.28
Gjithsej	325.29	309.69	Gjithsej	2,634.69	2,789.71

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës


Ushqimi, pijet dhe duhani gjatë vitit 2016 ishin kategoria me pjesëmarrjen më të madhe në import duke përbërë kështu 13.37% të importit në përgjithësi, pasuar nga kategoria makineria dhe pajisjet mekanike me 12.83%. Sa i përket eksportit metalet bazë ishin kategoria me pjesëmarrjen kryesore në eksport me 35.90% të pjesëmarrjes në totalin e eksporteve, pasuar nga produktet minerale me 20.63%.

Shqipëria është vendi i cili ka pjesëmarrjen më të madhe në eksportet e Kosovës me 13.58% të të gjitha eksporteve, pasuar nga Serbia me 13.35%, ndërsa nga vendet e BE prin Gjermania me 4.47%. Sa i përket importeve, Serbia është shteti nga i cili importohen më së shumti mallra, me një pjesëmarrje në totalin e importeve me 13.90%, e pasuar nga Gjermania me 12.29%, dhe Turqia me 10.34%.

Klima e të bërit biznes


Perceptimi i bizneseve për klimën e të bërit biznes në tremujorin e katërt të vitit 2016 është më pozitiv krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2015. Sa i përket sektorëve, në raport me tremujorin e tretë të vitit 2016 kemi një rënie tek shitja me pakicë dhe shërbimet, përderisa tek sektorët tjerë kemi ngritje. Gjendja aktuale tek shitja me shumicë ka shënuar rritje në raport me TM3 2016, për 16.5 p.p., ndërsa në raport me TM3 2015 ka shënuar rritje për 28 p.p. Tregtia me pakicë ka rënë në raport me TM3 2016 për 20 p.p. Ndërsa, ndërtimtaria në raport me TM4 2015 ka shënuar ngritje për 2 p.p. Pra pritjet e përgjithshme zbulojnë se ka një klimë pozitive për afarizëm.

Figura 3.1 Gjendja aktuale, ndryshimi në p.p.



Burimi: Oda Ekonomike e Kosovës

Figura 3.2 Pritjet e përgjithshme, ndryshimi në pikë për qindje



Burimi: Oda Ekonomike e Kosovës

Siç shihet në Figurën 3.2, bizneset në sektorin e shërbimeve kanë pasur përmirësimin më të madh sa i përket pritjeve për klimën e biznesit. Ky sektor ka një rritje prej 34.5 p.p. në raport me TM3 2016. Një optimizëm i dukshëm nga ana e bizneseve vërehet edhe për sektorin e ndërtimtarisë dhe atë të tregtisë me shumicë. Sa i përket sektorëve të përpunimit dhe shitjes me pakicë, figura dëshmon se pritjet e bizneseve janë se do të vazhdojë të ketë klimë të favorshme në të bërit biznes.

Kutia 1. Vlerësimet nga raporti 'Doing Business'

Raporti i **Bankës Botërore** për të Bërit Biznes 2017 konfirmoi progresin e arritur nga Republika e Kosovës në përmirësimin e ambientit biznesor, duke ngritur rangimin e saj botëror në vendin e **60-të nga vendi i 64-të** në të cilin ishte Kosova pas revidimit të raportit të mëparshëm. Dhjetë indikatorët e Raportit të Bankës Botërore për të Bërit Biznes vlerësojnë qeverisjen dhe lehtësinë e të bërit biznes në një mori të fushave ligjore, rregullatore dhe operacionale.

Kosova ka shënuar progres në disa indikatorë. Në veçanti është bërë progres i konsiderueshëm për indikatorët në vijim:

- Fillimi i një Biznesi nga vendi i 27-të në vendin e 13-të. Ndikim të madh në këtë përmirësim kishte:
 - Shmangia e vizitës edukuese nga Administrata Tatimore e Kosovës me rastin e hapjes së një biznesi, reformë kjo e cila ka rezultuar në shkurtimin e procedurave për fillimin e një biznesi.
- Pagesa e Tatimeve nga vendi i 77-të në vendin e 43-të. Ndikim të madh në këtë përmirësim kishin:
 - Shmangia e kontakteve fillestare me bizneset;
 - Ofrimi i mundësisë së deklarimit 100 % online të deklaratave tatimore;
 - Njohja e shpenzimeve të trajnimit si pjesë e pakos së fundit fiskale.
- Tregtia Përtej Kufijve (nga vendi i 59-të në vendin e 51-të) ndikim të madh në këtë përmirësim kishin:
 - Opercionalizimi i plotë i sistemit ASYCUDA World;
 - Korridori për transit Kosovë – Shqipëri;
 - Thjeshtëzimi i procedurave të zhdoganimit (dogana pa letër, e-pagesa, mundësia e zgjedhjes së terminalit më të afërt doganor, kontrollet sipas përzgjedhjes së bazuar në risk);
 - Organizimi i trajnimeve për tregtarët dhe agjentët doganor mbi sistemin e menaxhimit të riskut për eksport.

Përveç përmirësimit të rangimit botëror, përmirësimet në këta indikatorë janë ngushtë të ndërlidhur me reduktimin e korrupsionit, prosperitetin ekonomik si dhe efikasitetin e përgjithshëm në qeverisje.

Sektori Fiskal


Të hyrat e përgjithshme buxhetore vazhdojnë të kenë performancë të mirë, ku vetëm gjatë tremujorit të fundit të 2016 u arkëtuan 412 milionë euro. Ngritje e theksuar u tregua përgjatë gjithë vitit, ku deri në fund të TM4 2016, të hyrat e përgjithshme buxhetore kanë shënuar një ngritje prej rreth 10.6% në raport me të hyrat totale të vitit paraprak. Ngritja e përgjithshme në arkëtim vjen si rezultat i aktivitetit të shtuar ekonomik në vend. Masat e reja në politikat tatimore, reformat e ndërmarra nga agjencitë e të hyrave për ngushtimin e hendekut tatimor, lirimet për lëndët e para dhe makineritë në import, fillimi i implementimit të përshkallëzimit të TVSH-së dhe efekti i Ligjit për faljen e borxheve po ashtu këtë vit ishin shtytës shtesë për performancën e lartë të të hyrave.

Në TM4 2016 shpenzimet totale ishin 573 milionë euro, apo 8.1% më të larta se në TM4 2015. Vërehet se gjatë tre muajve të fundit të 2016 shpenzimet patën një ngritje të dukshme; kjo ndodhi kryesisht për të financuar projekte kapitale. Në përgjithësi, shpenzimet kapitale gjatë vitit 2016 kanë shënuar rritje të lartë në krahasim me vitin e kaluar, duke u ngritur për rreth 9.8%. Kontribut të theksuar gjatë kësaj periudhe kanë dhënë edhe shpenzimet për subvencione dhe transfere. Ndërsa, sa i përket shpenzimeve totale, ato gjatë vitit 2016 shënuan një ngritje prej rreth 7% në raport me shpenzimet e vitit 2015.

Borxhi i përgjithshëm ndërkaq vazhdon të mbetet relativisht i ulët. Deficiti si përqindje e BPV-së për vitin 2016 vlerësohet të jetë 1.6%; ndërsa stoku total i borxhit të përgjithshëm në fund të TM4 2016 është


14.5%, ende larg pragut prej 40% që është edhe kufiri i paraparë me ligj për borxhin.

Figura 4.2 Të hyrat, 2015 - 2016




Burimi: Departamenti i Thesarit dhe Njësia e Makroekonomisë – Ministria e Financave

Figura 4.3 Shpenzimet, 2015 - 2016



Burimi: Departamenti i Thesarit dhe Njësia e Makroekonomisë – Ministria e Financave

Figura 4.1 Të hyrat, shpenzimet, dhe deficiti primar, 2015 - 2016



Burimi: Departamenti i Thesarit dhe Njësia e Makroekonomisë – Ministria e Financave

Sektori Financiar


Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2016, normat e interesit tek kreditë e reja shënuan rënie në krahasim me tremujorin e tretë; nga 7.32% ato zbritën në 7.27%. Gjithashtu edhe norma e interesit te depozitat e reja pësoi rënie nga 1.15%, sa ishte mesatarja në tremujorin e tretë 2016, në 1.05% në tremujorin e katërt. Sektori financiar mbetet një kontribuues i rëndësishëm në financimin e ekonomisë së vendit. Bazuar në të dhënat e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), asetet totale financiare në Kosovë, gjatë tremujorit të fundit të vitit 2016 shënuan rritje për 7% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, duke arritur kështu në 3.6 miliardë euro në fund të periudhës raportuese.

Përderisa kreditë shënuan rritjen më të madhe vjetore prej 10%, duke shënuar kështu përmirësime përgjatë gjithë vitit 2016, depozitat shënuan rritje prej 7% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo e bën që ky sektor të mbetet mirë i kapitalizuar, likuid dhe profitabil, si rezultat i përpjekjes për të ndjekur politikën e reformave të vazhdueshme për stabilitet makroekonomik dhe zhvillim financiar. Zhvillimet rreth depozitave dhe kredive janë paraqitur edhe në Figurën 5.2, ku vërehet një trend gradual në ngritje.

Normat e interesit tek kreditë e reja gjatë vitit 2016 pësuan rënie në krahasim me vitin 2015. Tek kreditë e reja normat e interesit gjatë vitit 2016 kishin një mesatare prej 7.47%, përderisa gjatë vitit 2015 kjo normë mesatare ishte 8.32%. Përderisa, norma e


interesit tek depozitat e reja gjatë vitit 2016 u ngrit në një mesatare prej 1.01%, nga 0.90% sa ishte në vitin 2015. Disa faktorë që mund të kenë kontribuar në këtë trend negativ të normave të interesit janë edhe operimi i suksesshëm i përmbaruesve privatë dhe aprovimi i Ligjit për Falimentim.

Figura 5.1 Trendi i normave të interesit dhe depozitave



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Figura 5.2 Trendi i kredive dhe depozitave



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Tabela 5.1 Depozitat, Kreditë dhe Asetet Totale, milion euro

	TM4 2015			TM4 2016		
	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Depozitat	2,635	2,628	2,703	2,775	2,786	2,898
Kreditë	2,006	2,015	2,020	2,197	2,212	2,230
Asetet totale	3,332	3,339	3,385	3,505	3,518	3,637

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Përshkrimi	Njësia	2013	2014	2015	2016			
					TM1	TM2	TM3	TM4
SEKTORI REAL								
Bruto Produkti Vendor	çmime konst, ndryshimi në %	3.4	1.2	4.0	3.8	3.3	3.8	:
IÇK	ndryshimi në %	1.8	0.4	-0.5	0.1	-0.2	0.2	1.0
Ushqimi dhe pijet	ndryshimi në %	2.1	-0.2	0.4	-0.3	-0.9	-0.7	0.5
Çmimet e importit	ndryshimi në %	0.2	-0.4	-1.2	-4.4	-3.9	-2.8	:
Çmimet e prodhimit	ndryshimi në %	2.4	1.7	2.7	-0.5	:	:	:
TREGU I PUNËS								
Norma e punësimit	ndryshimi në %	28.4	26.9	25.2	25.5	27.9	29.2	:
Norma e papunësisë	ndryshimi në %	30.0	35.3	32.9	27.7	26.2	27.5	:
SEKTORI I JASHTËM*								
Importi i mallrave	c.i.f., mil. euro	2449	2538	2635	562	736	744	748
Eksporti i mallrave	f.o.b., mil. euro	294	325	325	72	81	74	84
Bilanci tregtar	mil. euro	-2155	-2214	-2309	-490	-656	-671	-664
Importi i mallrave dhe shërbimeve	mil. euro	2094	2070	2140	474	619	571	:
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	mil. euro	1169	1253	1277	225	252	653	:
Bilanci i llogarisë rrjedhëse	mil. euro	-339	-540	-697	-171	-295	14	:
Bilanci i llogarisë rrjedhëse	% e BPV	-6.4	-9.7	-12.1	-13.9	-19.7	0.8	:
Investimet e Huaja Direkte	bilanci, mil. euro	250	124	272	53	31	74	:
Remitancat	bilanci, mil. euro	573	622	665	144	177	182	:
SEKTORI FISKAL								
Të hyrat e përgjithshme prej të cilave:	mil. euro	1329	1345	1470	-	-	-	1607
Të hyrat nga tatimet direkte	mil. euro	174	188	198	-	-	-	234
Të hyrat nga tatimet indirekte	mil. euro	985	1007	1107	-	-	-	1229
Shpenzimet e përgjithshme prej të cilave:	mil. euro	1479	1480	1564	-	-	-	1671
Shpenzimet rrjedhëse	mil. euro	946	1058	1149	-	-	-	1220
Shpenzimet kapitale	mil. euro	529	411	404	-	-	-	444
SEKTORI FINANCIAR								
Depozitat	mil. euro	2450	2538	2703	-	-	-	2898
Kreditë	mil. euro	1806	1882	2020	-	-	-	2230
Asetet totale të sektorit financiar	mil. euro	3060	3187	3385	-	-	-	3637
Norma e interesit në kredi	%	11.8	10.6	8.3	7.8	7.5	7.3	7.2
Norma e interesit në depozita	%	3.4	1.1	0.9	0.9	0.9	1.2	1.0
Norma e këmbimit	EUR/EUR	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0
Norma reale efektive e këmbimit	indeks	106.5	106.7	104.7	105.5	103.8	103.9	105.2

*Diskrepancat e mundshme me publikime tjera të Njësisë (tek sektori i jashtëm) vijnë si pasojë e ndryshimeve metodologjike në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave nga BQK, pasuar edhe me revidim historik

Të dhënat tek Sektori Fiskal për vitin 2016 bazohen në raportin preliminar 2016 të Thesarit

(-) raportohen si kumulative (fundit i periudhës); (:) të dhënat nuk janë të disponueshme